


BIBLIOTEKA  
SHTETIT

81H-7

299



Kopi Kycyku

# ME SHTATE FIKS

poezi satirike


814-7

KPP

KOPI KYÇYKU

# MË SHTATE FIKS

poezi satirike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»


## JAM NJERI ME INTELEKT...

— Jam njeri me intelekt,  
e kam kokën plotpërplot,  
po kam vetëm një difekt,  
që, sa di, s'jua them dot...

Kam haber nga letërsia,  
nuk jam mjek e dini mirë,  
po marr vesh nga mjekësia,  
për çdo dije kam dëshirë...

Njoh krejt shkencën botërore,  
fluturimet me raketë,  
reaksionet bërthamore  
t'i zbërthej e kam fort lehtë...

Ja vë moshën me të parë,  
çdo skeleti a gjymtyre,  
arkeologëve u jap mend  
dhe nuk pres kurrjë prej tyre.



Dhjetë gjuhë i di ujë fare  
me të shkruar e lexuar,  
para meje s'vlen një pare  
as njeriu m'i shkolluar...

— Se sa di, mos na e thuaj,  
bëj sa thua, more trim,  
ne kuptojm' që koka jote  
kashtë ka, ndaj flet qesim.

Mburru, pra, përse të druhash?  
Ti për dijet je krenar,  
por askujt sot nuk i duhash,  
magazin' pa inventar!

## ARROGANTI

Vetullat, ballin — një qiell me re,  
që shi e breshër veç nxjerr nga goja,  
siç thot' dhe vetë: helbete,  
ca ia do puna, ca nga nevoja.

Mendjen s'ia mbush dot kurrë asnjë  
dhe gjë prej gjëje s'i hyn në sy,  
mbi gjithë zërat, vetëm një zë  
e ka për zemër — zërin e tij...

Ndaj e ngre lart, deri te retë  
edhe në pastë posht' thatësi,  
zëri i tij — gjëmimi vetë,  
ua mbledh shpejt reve të japin shi...

Ashtu vazhdon ky tip nevriku  
të tjerëve t'u japë «dush»...  
... Vetëm diçka harron lum miku:  
se edhe rrufesë ia mbledh dikush!



## QULLI, SULO QULLI

Sulo Qullin ju s'e njihni,  
burrë i urt' si veç ai,  
fjal' të ashpra dot s'i gjeni,  
se s'i mban fjalori i tij...

Ësht' i dashur dhe i shkuar  
gojë s'prish me asnjeri,  
i merr punët butë, shtruar,  
të beson, pa një pa dy.

Të dëgjon me dor' në zemër,  
(pun' mos prit të të mbarojë),  
po ç'të keqe ka, vëllezër,  
gjersa mjaltë mban në gojë?

Për çudi veç këtë mjaltë  
as qyteti dhe as fshati  
s'e kërkon (nami mos daltë...),  
qenka mjaltë... burokrati!



## NUK ËSHTË DETYRA IME...

Çela Nazja, kur punon  
gjërat mrekulli i ndan:  
— Kjo, vëlla, nuk më takon,  
as atë s'e kam në plan. . .

Ç'më përket brenda sektorit,  
të përgjigjem gjer në një,  
as me urdhër të drejtorit  
s'kap me dorë tjetër gjë.

Gjersa s'është' detyra ime  
dhe askund s'e kam të shkruar,  
nuk përgjigjem as një qime. . .  
E, a mbetet të sqaruar? —


— Nuk përgjigjesh asnjëherë  
se merr masa, domosdo, —  
po përgjigjesh dimër-verë  
kur thërret një. . . bordero!

## KUR VJEN INSPEKTORI...

— Burri im në komitet,  
(ju e njihni, padyshim),  
me pozitë alamet,  
ka kulturë dhe arsim...

Pa më vjen sot inspektori  
dhe më bën kontroll në klasë  
e ma pret pa pikë zori:  
«Këta nxënës qenkan dërrasë!»

Besa, kjo s'durohet kurrë,  
inspektori sa ti s'di...  
Qysh harroi se paske burrë  
më të lartë se ai?



312-X=

INSPEKTORI

# PROFESIONI IM

*(Monologu i gënjeshtarit)*

Që kur bota u krijua,  
gjithë njerëzit u kujtuan  
të mësojn' nga një zanat;  
me ca gurë të lëmuar  
shumë her' patën sulmuar  
egërsirat shpat më shpat.  
Ky ka qen' zanati i parë  
dhe e pat emrin gjahtar.  
Pastaj dolën anembanë  
shumë bujq e artizanë,  
opingarë, futbollistë,  
rrobaqepës e artistë,  
mekanikë, elektrikistë,  
mjek', dhaskenj edhe dentistë,  
drupunonjës e kovaçë,  
ca të zot e ca kërpaçë...

Shum' zanate i pëlqenin,  
ca të tjerë i urrenin,  
në të dytin grup, o miq,  
pra, në zanatet e liq,

futën dhe zanatin tim;  
por, ju them, e kan' gabim  
dhe gabim shumë trashanik,  
se nuk është' aspak i lig.  
Ky zanat me pak vullnet  
të nxjerr shpejt në selamet...

Po t'jesh nxënës, s'digjesh, kurrë:  
«Profesor, isha sëmurë!  
«Profesor, më vdiq dje gjyshi!...»  
Dhe, tak-fak, shpëton nga dyshi...

Se zanati i gënjeshtarit  
kurdoher' i bie qarit...  
Veç një dëm të sjell ai  
se... nuk të beson njeri!

## NXËNËSI PLAK

Vëllai i vogël çdo mëngjes,  
i afrohet me kujdes,  
ty-ty-ty i bën në vesh,  
që të zgjohet.

Po Hasani, «nxënësi plak»,  
rri tulitur në krevat,  
na gërhet me shumë shamat'  
dhe mbulohet.

Ha mëngjesin me të shpejtë,  
sypalarë, siç ka fjetë,  
flokët si iriq përpjetë,  
ora tetë.

Kërkon librat, po më kot,  
as qiriu s'ia gjen dot,  
me to bubi, macja lot,  
siç din' vetë.

Pas mësimit, «nxënësi plak»,  
(ka tre vjet në klas' të shtat'),  
shkon, hedh librat në dollap,  
fle i qetë...



Ëndërron, medet, një dërrasë  
dhe mësuesin në klasë,  
para tij nuk di të flasë  
siç ndodh shpesh...

Po në çastin e vështirë,  
prej sikletit i dërsirë  
zgjohet shpejt dhe shpëton mirë  
pa një tresh...



## VETËM PESË MINUTA!...

— Vetëm pes' minuta kemi,  
një takim të shkurtër fare,  
do të njoftojmë se ku jemi,  
me detyrat njëvjeçare.

Lanë punën dhjetra vetë  
dhe u mblodhën në një sallë,  
ikën pes' minuta, dhjetë...  
«Kur do të fillojmë, vallë?»

U hap plot pas gjysmë ore  
«Mbledhja e shkurtër», pra, «takimi»  
(që të ngrysej desh dhe ca)  
dhe u mbyll kur erdhi agimi...



## RECIPROKE

Në klub, një natë pashë dy drejtorë,  
që dhanë edhe morën plot tri orë,  
përqark një tavoline t'rrumbullaktë,  
si miq të ngushtë e shokë të flaktë.

Thanë e ç'nuk thanë, kokë më kokë,  
(shejtan i madh rakia, ta zgjidh gojën)  
xhymert të bën e mend të jep me okë,  
ta qash një hall dhe ta plotsosh nevojën.

Dhe «brompi» i dhjetë lidhi marrëveshjen,  
pa firmë e pa kurrfarë «burokraci»,  
kërkesat paralele e thyen heshtjen,  
i mëngjri tha: «Të parë të lë ty».

I djathti u përtyp e zu ngadalë:  
— Mbeta pa Gaz, e kam në ofiçinë,  
komshiu në Tiranë e ka një djalë,  
të shtruar ka dhe gruaja dainë.

— Mbaroi! Tani dëgjomë edhe mua,  
ibret më mbeti dhoma higjienike,  
një galexhant importi nga ti dua,  
ca pllaka dhe ca bojë çimentike.

... Të gjata ishin listat «miqësore»,  
i ëmbël muhabeti i rakisë,  
por ua prishi klasa punëtore  
allishverishet e burokracisë...

Në fyt u mbetën mezet dhe premtimet  
kur mbetën shtang me listat nëpër duar...  
... Edhe vazhduan qarkullimet  
për t'u freskuar!

## TELI NË UROF

Tërë ditën në urof  
rraskapitej Teli,  
edhe psherëtinte: Of,  
ç'po më therr ky beli!

— Ç'bën kështu, mor shoku Tel,  
djersa të shkon lumë...

— E po unë s'jam dembel,  
merrem veç me punë...

— Ti po lodhesh, nuk them jo,  
lodhesh kot, bre burrë...  
Grurë mbill dhe, më beso,  
s'e ndien lodhjen kurrë...

## KURSIMET DHE XHELOJA

— Kurseni, shokë, sa më shumë,  
si nuk e vini, xhanëm, re,  
leku i popullit po derdhet lumë  
dhe asnjëri meraku s'e ze!

Foli e foli si orator,  
Xhelo Cinguni plot gjysmë ore,  
ndërsa llambushkat në korridor,  
me faqet skuqur, qeshnin gazmore.

Kur shkante Xheloja përditë në zyrë,  
syri ia zinte me dhjetëra herë,  
po ku honepste ajo fytyrë,  
mbi çelësin dorën, o shok, të verë!

Një dymijvatëshe nën tavolinë,  
(një reflektor, diell i vërtetë),  
dimër e verë venat ia shkrin  
dhe gjumi ëmbël i vjen i lehtë.

Tek fliste Xheloja, ethet e kapën,  
bobo, kam frikë mos zjarr ka rënë!  
Drejt zyrës shpejt e mori vrapin  
se reflektorin ndezur kish lënë!



## IZMAVE

Ju kishit mbirë tokave djerrë,  
si gjemb, si hithër, si shkurre e ferrë,  
dhe ish një kohë që anembanë,  
shtriheshit fushave, maleve tanë.

Tani si dhitë ndër dhentë ngjani,  
si shkatërrinat ju ka zën' plani,  
lule të bukura e ngjyra-ngjyra  
ngado ka çelur te ne natyra.

Ky plugu ynë nuk do të lerë,  
asnjë pëllëmbë të mbetet djerrë,  
se e punojmë ne tokën thellë.  
Rrënjët përdredhur si gjarpërusha,  
do t'jua nxjerrim sipër, në diell,  
kudo t'i kini, dhe nën gëmusha.

## PESHKU I SHOQËRUAR...

Peshku s'është' i zgjuar,  
është truthartuar,  
gjersa bie aq lehtë  
në grep dhe në rrjetë.

Peshku tru nuk ka,  
por, ama, vëlla,  
mbi trurin vepron,  
le kur e shoqëron  
me një litër verë...  
Breshër le të bjerë!



## SI BËHET ÇASTI ORË...

O ju ka rënë,  
o do t'ju bjerë  
patjetër rasti,  
ju ndonjëherë,  
të shkeln brenda,  
o miqt' e mi,  
për riparime  
në ca njësi...  
«Të çastit» janë,  
pa u vonuar...  
... Po të del mjekra  
duke shpresuar...  
Atje dhe koha  
shndërrohet pa zor,  
minutat kthehen  
sakaq në orë...  
Veç një të mirë  
ka një torturë:  
sahati i tyre  
nuk punon kurrë...  
Dhe gënjen veten  
mos jesh mërziur...  
... Të duket se  
ti hiç s'ke pritur...



## DHËNDURË PA NUSE

Gjashtë shkurt '67-të,  
seç na i la me duar thatë,  
«kanunxhinjt' mustaqegjatë»  
me thes vitesh në kurriz.

Muhameti mbante shtatë.  
po s'ishin si burrat gratë,  
tani ngec ajo kafshatë  
dhe as kaq dot nuk lëviz.

Një të marrsh e të rrish mirë,  
mblesës ikni, lamtumirë...  
S'ka më pula dhe këndeza,  
nuk martoni dot dy breza!

## MË SHTATË FIKS!

Vetëm një kërkesë,  
kam për ju, o shokë,  
një minut' vonesë,  
nuk duron kjo kokë.

Më shtat' fiks ju dua  
të ndodhi në zyrë,  
ora shtat' për mua  
është si një pasqyrë,  
gjer në orën dy  
në daçi dhe flini,  
por, ama aty  
ju dua, ta dini!

## ANKIMET E QYTETIT

Ankohej sa s'qante qyteti,  
se qafa i dhimbte të shkretit,  
nga dhjetra e dhjetra çibanë  
në rrëzë, në mes e në anë.

Një kallo i digjte në këmbë,  
në goj' po i prishej një dhëmb,  
të ftohtë fort ndiente në duar  
se zhveshur i kishte, zbuluar.

«E dashura urbanistikë»,  
s'të ardhka për mua pak keq?  
S'e vret mendjen, xhanëm, një çikë,  
kur vizat pas qejfit i heq?

## SHURDHMEMECI NË RRUGË

Shef Shefqeti rëndë-rëndë  
po kalonte trotuarit  
kushedi se ç'kish ndër mend,  
kur... nga pas, zëri i Masarit:  
— Shoku shef, kam veç një fjalë,  
ndaj, të lutem, një minutë...  
Po Shefqeti nuk u ndal,  
se s'i kish «të meta» trutë:  
... Kur s'ka pranë telefon  
shefi s'flet e as dëgjon.

## HALLI I KLAJDIT

— Ç'ke, o Klajd, që rri mërzitur,  
qenke zbehur, je sëmurë?

— Më ka ngjar' një e papritur,  
që s'ma merrte mendja kurrë.

Xheni sot prishi fejesën,  
pra më la pa asnjë shkak...

— Pse s'i the, që ke një gjysh  
shum' të pasur, mor guak!

— Se m'i nxori ato fjalë  
goja ime me yrysh,  
pa më la me bisht në shalë:  
u martua me tim gjysh!

## VELO ÇORBA

Velo Çorba është shef  
dhe lëvdatat i ka hak,  
se çdo pun' e bën për qef,  
me durim atë vandak  
për çdo dit e pasuron;  
kur më shpejt se vet' rrufeja  
orë e çast nxjerr shkresa t'reja  
dhe po nxihet letr' e gjorë  
pa kursim nga ajo dorë...  
— Fjalët, shokë, i merr era,  
pra, çdo gjë e dashka shkruar, —  
nëpër mbledhje, thot' ngahera...

Po dikush në atë sallë  
u ngrit e tha ndër të tjera:  
— Mos harro, punën e gjallë  
kurrë nuk e merr dot era!



## ZYLUA DHE BYRAZERI...

Po vrisja mendjen ditë me radhë  
ç'ka vallë, Zylua, që nuk më flet?  
Kur e sjell rasti t'i dal përballë  
bën majtas-djathtas dhe ka siklet...  
Si fanatikë poshtë ul sytë,  
a, kërkon yje mu në mesditë...

Dhashë edhe mora e më s'durova,  
një ditë Zylon rrugës ndalova;  
— Dhe merr guximin, më quan shok!  
Je bukë e thyer... Nuk të ngjis dot!  
Një herë t'u luta për tim vëlla  
që t'i dhuroje në vjeshtë një pesë...  
Qendrimi yt, që shembull s'ka,  
u bë shkaktar që ai të mbesë!  
Me ty nuk kam më muhabet,  
që atë ditë ka lindur sheri...

— Çudi, — ia prita, — ti nuk më flet,  
po më ka mik sot byrazeri...

## JO, PËR NDER!...

Do të shkoj, ku është' nevoja,  
shokëni e shoqeni,  
ma thot' zemra, s'ma thot' goja,  
s'ju gënjej, besomëni!

Do çaj toka dhe kanale,  
nuk do rri më un' në zyrë,  
more do sheshoj dhe male  
po ma vutë si detyrë.

Si?! Dakord qënki me mua?  
Shoqeni e shokëni!  
Që të shkoj, oh, sa fort dua,  
po nuk mund, besomëni!

Sa largohem nga qyteti  
me zë gripi menjëherë,  
e, a kam faj un' i shkreti?  
Ju betohem: jo, për nder!

## RUSHITI DHE AJSHTAJNI

Kur bie në llaf Rushit Abazi  
gjithnjë me zell nis nga avazi:  
— Besoj ke qef dhe ti, o mik,  
të dish «*rektorin atomik*»<sup>1)</sup>  
çfarë është «*uzoni*»<sup>2)</sup> dhe «*tretosera*»<sup>3)</sup>  
e shum' e shum' gjëra të tjera...  
I njoh si bukën që ha çdo ditë,  
eja tek unë të t'i çel sytë...  
eja tek unë që pagdhirë,  
n<sup>u</sup>dh dhe Rainshtajnin shumë mirë...

S'e zgjata më: — Po ik, Hurshit!  
U hodh: — E kam emrin Rushit!  
— Por dhe ai s'e ka Rainshtajn,  
sa për dijeni është Ajshtajn!

---

1, 2, 3 — deformime të fjalëve «*reaktor atomik*», «*ozon*»  
dhe «*stratosferë*».

## DËMIN PËRGJYSMË!

N'autobus më takoi vendi  
mrekulli, përpara fare,  
u kënaqa kur mendova  
të sodisja në dritare.

Afër meje vjen e ulet  
një djalosh tridhjetëvjeçar  
e në çast veç më vërsulet  
me zjarr pyetjesh, si shpatar.

— Si të quajn', nga të kemi?  
Sa vjeç je? Tregoni m'i ri.  
Kur të zbresim, a nuk vemi  
ta bëjm bromp me një raki?

— As s'më thua sa klas' shkollë  
ke mbaruar? Ç'zanat di?


— Tetëvjeçaren e kam boll,  
s'e kam drejt, si thua, ti?...

Autobusi pas dy orësh  
zu të merrte një kthesë,  
iu mbush mendja dhe shoferit  
që të bënte pak ndalesë.

Gjeta rastin e i thashë  
— O djalosh, dil në të djathtë, —  
— Kam respekt, s'jam aq i trashë  
do të rri veç në të majtë!

— Mor, nuk është pun' respekti,  
po pun' veshësh, o djalosh,  
veshi i majt' po vdes i shkreti,  
ka rrezik ta flak në kosh.

Dëmi duhet përgjysmuar  
pesëdhjetë për qind çdonjëri,  
që sado i vagëlluar  
tek të dy të ndihet zëri.



SHKOLLA

## LUMANI NË MES TË ARSIMTAREVE...

Në mes të qytetit  
kemi ne një shkollë,  
që, sado ta mburrësh,  
kurrë s'është boll.

Le që si godinë  
nuk ke hiç ç'i thua,  
po dhe pastërtinë  
e ka nën thua.

Njëzet arsimtare  
punojn' me pasion,  
i njëzetenjëti  
shkollën e drejton.

Me arsim gjysmak  
dhe me pak kulturë  
drejtor e ka hak,  
se, fundja është' burrë!

## KRYESERVILI

Kryeservili  
Rudak Shamili  
(jo rastësisht  
i vunë gisht  
që n'kryesi  
të jetë ai):  
sistematik  
sa s'ka ku shkon,  
se pikëpërpik'  
i regjistron:  
ç'u fol për shefin  
në filan orë;  
kush ia prish qejfin  
shokut drejtor....  
Dhe, kur vjen puna,  
n'mbledhje vjetore,  
porsi furtuna  
me topa bore  
godet «mëkatët»  
në pe e gjilpërë,



që ndaj drejtorit  
të gjith' kan' bërë...

Për çdo kritikë  
ndizet bandilli,  
pranon drejtori,  
s'pranon servili...

## DËRRASA E FASLLIUT

— Unë i ziu,—  
tha Faslliu, —  
s'e pandeha  
kaq kiamet;  
për një dërrasë  
të kërcasë  
bam kritika,  
fletërrufetë!  
E po s'mbeti  
gjith' ky shtet  
për një dërrasë  
në siklet...

Për punëtor  
parimor  
gjer në kulm  
jam dhe vetë,  
dhe e mbroj,  
e forcoj  
pronën tonë  
ditë e natë...

Këtë dërrasë,  
që dha shkas  
të shpërthejë  
kaq shamatë,  
nuk e shqeva,  
e mbërtheva  
n'mall të shtetit,  
në pallat!

## UJDI ME LEVERDI...

— Ujdi me leverdi,  
te Daj Sami, myshterinj!  
Fort bërtet një ujk i zi...  
— Mos më shihni nga fytyra,  
mos më çmoni as nga ngjyra;  
e kam hijen ca të rëndë,  
kjo është fjalë shumë e rëndë  
porse zemrën po t'ma çani  
me zor lotët do t'i mbani,  
që menduat keq më parë.  
me dëshir' për të më vrarë.

«Marrëveshje për çdo çështje,  
zemërhapët, me buzëqeshje!»  
Fton klientët me zë basi  
ujku tjetër nga Kuzbasi.  
«Blini arm' të lira fare,  
qitën larg e me batare,  
bojatisur si më mirë,  
ndryshku i viteve krejt i fshirë»  
— Doni misër, merrni misër,

e këmbej me bakër blistër.  
«Gati jam për ndihm' teknike  
dhe për plehra fosfatike;  
pak tok' dua, o vende mike,  
të ngul bazat atomike».

Ujku i zi, si hija e tij  
dhe zë basi prej Kuzbasi  
bëjnë thirrje për tregti:  
— Askush rastin t'mos humbasi!

Si vullkan shpërthen i gjallë  
zëri i popujve valë-valë:  
— Kush me ju bën tregti  
shet, së shpejti, çdo liri...

## RRËZOKAN QIELLIN

Kur aeroplani hyri natën në Shqipëri,  
nja dhjetë udhëtarë që larg, nga «bot' e lirë»  
në kor, me kokat poshtë, me habi:  
— Ç'na shohin sytë, — klithën, — zot i mirë?!

Që vilat në qytete e fshat më fshat,  
ky popull kokëshkret' t'i konfiskoi,  
e dimë nga protestat në Papat,  
sadoqë tër' zahmeti kot na shkoi.


Po qiellin ta rrëzonte përdhe, kurrë  
s'na e merrte mendja, jo, moj perëndi,  
të qenkej ky millet kaq trim e burrë,  
sa yjt' i mbjell si grurin në malësi!

## NGUSHËLLIM

Legenë, rrogozë e sahanë,  
nga ishin e s'ishin, një ditë,  
u mblodhën që hallet të qajnë:  
mënjatë ç'i lanë të zinjte!

Krevatet, qilimat e pjatat,  
papritur, oh' vendin ua zunë,  
ç'të bëjnë tani, ah, të ngratët,  
vall' si do të vejë kjo punë?

— Na ndiht' ndonjë fat' paçim rast,  
na shpënçin atje në muze,  
vështir' do ta kemi, vë bast,  
se jemi jo pak, helbete!





## PA KURSIM...

Ka tridhjetë vjet që nuk pushoni,  
mbi tre dekada që veç dërgoni  
helm, parashuta, bomba, fletushka  
dhe nuk kursyet as dhe verdhushka...

Ju nuk tërhiqeni kaq lehtë  
po dridheni sa dridhen retë...  
Të lehin qentë, s'gjeni të çara,  
karvani ynë shkon përpara!

Dhe mos harroni se ne shqiptarët  
një amanet na lanë të parët:  
të mos kursejmë gjakun, as gjumin  
që mos t'ju lemë të hidhni lumin...

## SHQIPTARI I RI

— Ësht' a s'është ky shqiptari  
që kam njohur prej shum' vjet?  
S'qenka më ai i pari  
ka ndërruar sjellje e jetë...


A s'e derdhte nga frëngjitë  
ndër hakmarrje gjakun dje?  
Tani rri vërtet' në pritë,  
po në shenjë na ka ne.

A nuk rronte me bagëtinë,  
dje shqiptari në konak,  
a nuk hante dhallë e hurrë,  
dhjetë vetë në një çanak?

Shih tani, pyll me antena,  
na ka ngritur maj' çatisë  
dhe i jep mendje një bote;  
me çuditë e Shqipërisë.

Trimërinë e ka patur,  
po tani e shtoi pa anë,  
ta sulmoj, sa her' jam matur,  
por s'ma mban, se gjej belanë. . .

— Mos harro, kështjella jonë  
shumë zverqe i ka thyer. . .  
Kur të vish merr dhe qivurin  
brenda ke për t'u mbërthyer. . .



## ME RADHË

Gomari dhe elefanti,  
Durimmadhi dhe gjiganti,  
merren vesh për bukuri,  
n'Amerikën plot «Liri».

Brenda në Shtëpinë e Bardhë,  
në kolltuk ulen me radhë,  
se njëherazi të dy  
nuk i nxe vendi aty.

Si në trup, edhe në veshë,  
ç'është e drejta kan' dallime,  
ama hanë një përshesh  
ndaj në tru s'kanë ndryshime...

## NË PAVIJONIN E SHQIPËRISË

Një zë i çjerrë  
larg dërdëlliste:  
«Shqipni e mjerë...»  
Ndërsa pavijoni  
nga mallrat ndriste.

Fotografitë,  
e tërë jeta  
shpërndanin dritë  
si e vërteta!

Bakri dhe kromi,  
stofi m'i mirë  
i thanë zërit  
në shkretëtirë:

— Harro, moj mushkë,  
ti Valarenë...  
Në Shqipëri  
shpresat t'u prenë!...

## REVOLUCIONI KULTURAL-PROLETAR

Ndër dhoma t'errta si vetë nata,  
ndër ethe Londra, Madridi, Boni,  
Moska, Varshava dhe Xhakarta,  
Roma, Berlini e Uashingtoni;  
me teletajpe hallet i qajnë:  
«Në Kin' të Kuqe një arm' e re!!  
S'është' ajo bombë, atom s'përmban,  
por të rrëzoka shakull përdhe;  
dhe paska rreze të gjat' veprimi,  
nuk pyetka detet e largësinë,  
i rënka botës si vetëtimë  
djegka armiqtë vrimë më vrimë.

Me val' të shkurtra, të mesme, t'gjata,  
me lepur n'bark Londra e Boni,  
me shpirt ndër dhëmbë Moska, Xhakarta,  
me gjak të ngrirë Uashingtoni.

Vërtet skuq fort çdo rrugë e mur,  
n'Shangaj, Nankin, Hanxhou, Pekin,

kudo t'zë syri një det flamuj,  
nën qiellin të kaltër, që bukur ndrin.


Si diell i kuq, çdo proletari  
i ndriçon udhën kjo armë e re,  
tigrat prej letre po i djeg zjarri,  
diellin dot shosha nuk e ze.



## HA REKLAMAT!

*(Zemërgjerësi amerikane)*

Nga xhamat  
reklamat  
ia bëjnë me sy:  
dhe mishin,  
dhe vezët  
ai sheh aty.  
Pa fjalë,  
ngadalë  
fillon të largohet;  
uritur,  
mërzitur  
nuk di ku drejtohet.  
Pronari,  
pazarit  
fodull shkon e vjen:  
— Ti punë  
tek unë  
vërtet nuk po gjen;  
po fama,  
reklama  
e ime t'ushqen;



Shikoi,  
shijoi  
reklamat e mia:  
N'dollarë  
jan' larë,  
harrohet uria!

## PASQYRA E LËNDËS

Jam njeri me intelekt .....	3
Arroganti .....	6
Qulli, Sulo Qulli .....	8
Nuk është detyra ime .....	9
Kur vjen inspektori .....	10
Profesioni im .....	12
Nxënësi plak .....	14
Vetëm pesë minuta!.. ..	17
Reciproke .....	18
Teli në urof .....	20
Kursimet dhe Xheloja .....	21
Izmave .....	23
Peshku i shoqëruar .....	24
Si bëhet çasti orë .....	25
Dhëndurë pa nuse .....	27
Më shtatë fiks .....	28
Ankimet e qytetit .....	29
Shurdhmemeci në rrugë .....	30
Halli i Klajdit .....	31
Velo Çorba .....	32
Zylua dhe byrazeri .....	33
Jo, për nder!.. ..	34
Rushiti dhe Ajnshtajni .....	35
Dëmin përgjysmë! .....	36

Lumani në mes të arsimtarëve .....	39
Kryeservili .....	40
Dërrasa e Faslliut .....	42
Ujdi me leverdi .....	44
Rrëzokan qiellin .....	46
Ngushëllim .....	47
Pa kursim .....	49
Shqiptari i ri .....	50
Me radhë .....	53
Në pavijonin e Shqipërisë .....	54
Revolucioni kultural-proletar .....	55
Ha reklamat! ... ..	57